



# LISTË KONTROLLI HAP PAS HAPI PËR VERIFIKIM FAKTESH

## KONTROLL I SHPEJTË



### RUAJE PËRMBAJTJEN

Bëjeni screenshot ose kopjojeni përmbajtjen.



### ÇFARË PRETENDON PËRMBAJTJA?

A është fakt, interpretim apo tregim mbi atë kush ka të drejtë/gabim?

A është emocionale apo përpiqet t'ju bindë për diçka?



### KONTROLLONI SHENJAT E SHPEJTA TË RREZIKUT

Përdorni këto pesë pyetje:

1. **Kornizimi** - Çfarë theksohet? Çfarë lihet jashtë?
2. **Gjuha** - Neutrale apo emocionale/e ngarkuar?
3. **Balanca** - A paraqiten më shumë se një perspektivë?
4. **Konsistenca** - A ndryshon përgjigjja në mjete ose gjuhë të ndryshme?
5. **Shpërndarja** - A e keni parë të njëjtin formulim në media apo rrjete sociale?

✓ Nëse dy ose më shumë duken të dyshimta → vazhdo me verifikim.



## VERIFIKONI ME MJETE TË THJESHTA (OSINT BAZIKE)

### Imazhe

- *Google Lens / Bing Visual Search* → gjeni origjinalin
- *TinEye* → versioni më i hershëm
- *FotoForensics / JpegSnoop* → shenja manipulimi

### Video

- *InVID* → kontrolloni frame-t
- *YouTube DataViewer* → koha e ngarkimit
- *Deepware / Hive* → kontrole për deepfake

### Teksti / Përgjigjet e chatbot-it

- *GPTZero / Hive / ZeroGPT* → indikatorë të tekstit nga AI (jo 100% të besueshëm)

### Burimi & Shpërndarja

- *WHOIS / Wayback* → origjina e faqes
- *Hoaxy / Botometer* → shpërndarja & sinjale aktiviteti të koordinuar

✓ **Kërkoni postime identike, rritje të papritur, llogari të dyshimta.**

## KËRKONI PËR MODELE

- I njëjti mesazh, fjalë për fjalë?
- E njëjta narrativë në disa platforma njëkohësisht?
- Ngjan me narrativa të njohura propaganduese?

✓ **Nëse po → ka gjasa të jetë e koordinuar ose e formësuar nga AI.**



## VLERËSONI NDIKIMIN E MUNDSHËM

A mund të prekë, për shembull:

- zgjedhjet?
- çështjet e identitetit apo të pakicave?
- kujtesën historike?
- besimin tek institucionet?

✓ **Rrezik më i lartë → veproni me kujdes.**



## ZGJIDHNI REAGIMIN E DUHUR

- **Gazetarët** → verifikojnë, kontekstualizojnë ose e kthejnë në artikull.
- **OJQ-të / edukatorët** → përdoren në trajnime ose aktivitete ndërgjegjëse.
- **Qytetarët** → mos e shpërndani pa u verifikuar.
- **Institucionet** → monitorojnë ndikimin në fusha të ndjeshme.
- **Studiuesit** → e regjistrojnë si rast për analizë.



## RUANI GJETJET TUAJA



- Mbani screenshot-in, linkun dhe shënimet.
- Etiketoni rastin ("gjeneruar nga AI", "deepfake", "bias i dyshuar").

✓ **Ndihmon në ndërtimin e vëzhgimit afatgjatë dhe krahasimeve.**

